



PLAKU SOFRONI

PËR SHPIRTIN DHE JETËN

174.

Cila është arma e armikut kundër shpëtimit tonë? Zilia! Në Ungjill Pilat e dinte se Hebrejtë nga zilia donin ta vrisnin Krishtin. Zilia është fuqia më e madhe e armikut! Prandaj para së gjithash duhet ta anashkalojmë mendimin për zili!

175.

Zilia është karakteristike e të gjithë njerëzve pavarësisht nga gjendja e tyre shoqërore. Dikush është gjithmonë më i fuqishëm se ne. Të tjerët gjithmonë kanë diçka që do të deshëm ta kemi dhe ne. Në gjendjen e zilisë i hedhim poshtë të tjerët dhe jeta me të vërtetë bëhet Ikonë e zezë dhe e ndarë e Zotit.

176.

Përpiquni asnjëherë të mos e fajësoni të afërmin por lutuni për të! Kur dikë e dënojmë për mangësitë e tij kjo do të thotë që nuk i shikojmë tonat!

177.

Në gjendjen e rënies sonë ne nuk jemi të aftë, me saktësi ta gjykojmë vëllain tonë. Mos jini kaç të sigurtë se vëllai juaj gabon! Mos e gjykoni!

178.

Më mirë është të mos gjykojmë! Të jetoj me frikën e Zotit, do të thotë të kem frikë ta gjykoj tjetrin në mënyrë të gabuar, e jo ashtu siç do ta gjykojë Zoti.

179.

Çfarë kërkoj kur e gjykoj vëllain tim? Meqënëse nuk e shikoj siç e shikon Zoti gjithçka do të jetë e gabuar. Filloni me këtë lutje, me mendimin të jeni të bindur të mos u gjykoni vëllezërve tuaj. Filloni me mall tu shërbeni të tjerëve, si Shën Silluani, i cili gjatë festimeve kërkonte tu shërbente qindra kallugjerëve në trapezari. Ishte shumë i lumtur të shikonte sa i do Krishti këta njerëz, këta fëmijë të Perëndisë. Ju shërbente me shumë dashuri. Kur punët e jetës së përditëshme kryhen në atë frymë mund të bëhen një ushqim shumë i këndshëm shpirtëror. Natën, falë kësaj gjendjeje shpirtërore për të shërbyer zemra juaj do të jetë shumë e butë, do të qani para Zotit për mangësitë tuaja, për mospërsosmërinë e dashurisë suaj.

180.

Vështirësia pët të bashkëpunuar me të afërmin gjithmonë del prej mosmjaftimit të lutjeve dhe dashurisë! Siç thotë Shën Silluan mund të ndodhë edhe përkrah lutjeve të zjarra përparimi të jetë i vështirë. Përkrah kësaj, pasi të realizojmë me sukses, në thirrjen e Emrit të Jezusit të jetojmë fort me ndonjë person, bëhemi të aftë të jetojmë me miliona persona të tjerë që dhe janë të ngjashëm.





181.

Të lutemi për tjetrin do të thotë t'i ndihmojmë! Falë gjendjes së mirë shpirtërore të zemrës sonë përkundrejt tij të mund t'i kundërvihet mendimeve negative, të cilat jo pa shkak mund t'i ketë kundër nesh. Përkundrejt kësaj të mos lutemi për të do të thotë se ju japim të drejtë, duke mos pasur dashuri prej nesh, mendimeve të këqia që mund t'i ketë kundër nesh. Ta ruajmë bashkimin në lutje, rreth gotës së Krishtit dhe do të shikojmë se është e lehtë të duam!

182.

Jini shumë të vëmendshëm! Mos i lejoni asnjë mendimi të keq të hyjë në zemrën tuaj!

183.

Mos i nënvleftësoni mendimet e këqia që mund t'ju kapin për të afërmin kur jeni në qelinë tuaj. Mbrohuni prej çdo fjale që mund t'ju fyejë! Kjo është shumë e rëndësishme! Mbani mend gjithashtu dhe fjalët e Krishtit: *Siç doni të veprojnë njerëzit me ju, kështu veproni dhe ju me ta!* (Llk. 6,31)

184.

Ta ndiqni veprën e këtij njeriu të cilin kaq shumë e donte Zoti, i Atit Misaili, igumeni i manastirit të shenjtë të Shën Pantelemonit, atëherë kur jetoja aty: *Në qoftë se dikush kundërshton, unë tërhiqem!*

185.

Kur jetoni në bashkësi kallugjere, kështu që, ju kanë pranuar të zgjedhurit e Zotit, dëshirojnë tu shërbeni, ta llogarisni vetveten jo të denjë dhe shumë të respektuar. Atëherë jeta juaj do të ndryshojë! Përkundrejt kësaj në qoftë se i gjykoni të tjerët për punë jo të rëndësishme dhe të përcipëta do të humbisni gjithçka.

186.

Çdo gjë që e fitoni nëpërmjet ngritjes suaj të brendshme reflektohet në jetën tuaj tek Zoti. Luftoni kundër çdo pasioni që nxit tek ju mendime gjykuese kundër të afërmit. Mos e pranoni atë që armiku jua jep në dorë kundër atij që është jo i drejtë me ju. Qoftë të jeni vetë në qelinë tuaj, qoftë edhe me të tjerët çdo mendim gjykimi, ngritje e brendshme negative, krijon çarje në kështjellën tuaj shpirtërore dhe në kështjellën e vëllazërimit! Asnjë mendim nuk lind dhe nuk kalon pa pasoja! Me mendime të mirë për çdo njeri që do të takoni, do të mund të zbuloni person të dashur. Në kundërshtim me këtë, me mendime të këqia fytyra juaj, fuqitë tuaja shpirtërore do t'i lëkundin marrëdhëniet tuaja me të tjerët dhe do të ndikojnë mbi mjedisit që ju rrethon. Kur bekimi është tek ju atëherë nuk i shikoni mangësitë e të tjerëve por vetëm vuajtjet dhe dhashurinë e vëllezërve.

187.

Është njëlloj e gabuar dhe mashtruese të presim përsosmëri në një bashkësi sa dhe përsosmëri të një personi. Së pari sepse dhe ne vetë nuk kemi paraqitje të vërtetë dhe të drejtë për atë, se çfarë konkretisht paraqet përsosmëria. E pastaj, sepse përsosmëria është gjendje e ngjashmërisë së plotë të Krishtit.

188.

Hiqeni prej vetvetes çdo shpirt të kureshtjes! Kryeni bindjen tuaj pa u shqetësuar se a e kryejnë të tjerët atë. Kur mungon kureshtja çdokush e fiton, sipas mendimit të Zotit, atë që i përket. Nuk mund ta mashtrojmë Zotin! Ai është kaq i fuqishëm dhe i drejtë sa nuk mund t'i fshehim asgjë!



Plaku Sofroni
PËR SHPIRTIN DHE JETËN

Biblioteka FJALA PREJ VODOÇËS

EDICIONI:
BANORËT E MALIT TË SHENJTË

LIBRI 2

Titulli në origjinal
PLAKU SOFRONIJ (SAHAROV)

PËR JETËN DHE SHPIRTIN

Përktheu nga greqishtja

Peshkopi i Strumicës Zoti NAUM

KISHA ORTHODHOKSE MAQEDONASE
EPARKIA STRUMICË

СТАРЕЦ СОФРОНИЈ
ЗА ДУХОТ И ЖИВОТОТ

189.

Dhuromë t'i vështroj gabimet e mia dhe të mos e gjykoj vëllain tim -thotë Shën Efremit në lutjen e tij. Në qoftë se fillojmë t'i krahasojmë përpjekjet tona me përpjekjet e të tjerëve armiku mund të gjejë mënyrë të na ligështojë.

190.

Kur midis një rëzve shfaqen përçarje, armiqësi, marrëdhënie të dhunëshme bashkësia nuk mund të rruhet ndryshe në qoftë se secili nuk i duron mangësitë e të tjerëve. Sipas Shën Apostull Pavlit më mirë është dikush të durojë padrejtësi sesa të bëjë padrejtësi (shiko 1 Kor 6,7 - 8).

191.

Në qoftë se vazhdimisht lutemi që të kemi dashuri për vëllezërit tanë, ta kalojmë rrugën e jetës sonë me të njëjtin shpirt dhe me bashkimin e dashurisë shpirtërore, atëherë realizimi i ngjashmërisë sonë me Krishtin do të jetë më lehtë! Përkundrejt kësaj, në qoftë se ndalemi në mangësitë e pakalueshme dhe gjërat e imëta të jetës së jashtme, atëherë do ta humbasim bekimin e vëzhgimit të të Përrjetshmit.

192.

Gjatë paraqitjes të çdo problemi, më të mëdhenjtë e vendosin vetveten në shërbim të të afërmit, kjo është e vetmja zgjidhje e mundshme! Siç thotë Krishti ata që duan të jenë të mëdhenj bëhen shërbëtorë dhe robër madje dhe të më të pafuqishmëve!

193.

Jeta tokësore është e themelohur mbi fuqi, mbi dhunë, qëllimi i të krishterit është krejtësisht ndryshe. Dhuna nuk i përket jetës së përjetëshme. Asnjë vepër që na jepet me dhunë nuk mund të na shpëtojë!

194.

Në jetën e përbashkët, bindja na imponon dalëngadalë ta kuptojmë psikologjinë e personave të tjerë. Duke u mësuar të jetojmë me një person, mësojmë të jetojmë dhe me miliona persona të tjerë që janë të ngjashëm. Kështu, shkallë - shkallë hyjmë në dhimbje të thellë për gjithë njerëzimin. Shpirti ynë duhet të zhvillohet në të gjitha përmasat e qenies njerëzore, dhe jo vetëm në fushën e vështirësive dhe halleve të përditëshme. Ato gjëra të vogla, dhe mosmarrëveshjet që i shoqërojnë, gjithsesi janë të pashmangëshme, por ajo nuk është qëllimi përfundimtar i ekzistencës sonë. Emërtimi ynë është të përshatemi sipas *Shembullit* të Krishtit. Megjithatë, në qoftë se “unë” nuk mund të mbaj në vetvete një vëllazërim të vogël si do të mund me dashuri ta përqafoj, si Krishti, njerëzimin e përgjithshëm në kohë dhe hapësirë.

195.

Të jetojmë si të krishterë do të thotë të jemi të ngjashëm me Krishtin, t'i kemi të njëjtat të trokitura të zemrës, të njëjtën mendje me Birin e Perëndisë, siç na thotë Shën Apostol Pavle. Në qoftë se e posedojmë dijen e këtij qëllimi mendja nuk do të humbasë në gjërat e imëta. Dëshirat, zilia, mosmarrëveshjet dhe problemet e vogla të jetës së përditëshme do të kalojnë pa u vërejtur fare.

превод на албански: Јордана Шемко

